

SAJBËRDHUNA

Sajbërdhuna është përdorimi i qëllimshëm dhe i përsëritur i mjeteve elektronike nga fëmijët dhe adoleshentët për të ngacmuar, kërcënuar, munduar, poshtëruar, turpëruar apo përdorimi i ndonjë forme tjetër të dhunës ndaj një fëmije apo adoleshenti tjetër. Rezultatet nga hulumtimi tregojnë se:

- 28% e fëmijëve kanë përjetuar sajbërdhunë në 12 muajt e fundit;
- 53% e sajbërdhunës është bërë përmes rrjeteve sociale;
- 34% i fëmijëve të prekur nga sajbërdhuna kanë deklaruar që janë shumë të shqetësuar;
- 25% nuk kanë biseduar me dikë lidhur me sajbërdhunën e përjetuar në internet;
- 15% kanë deklaruar se vetë kanë ushtruar sajbërdhunë ndaj të tjerëve, prej të cilëve 18% e kanë bërë çdo ditë apo gati çdo ditë;
- 25% e fëmijëve kanë pohuar që zihen në shkollë më shokët/shoqet për shkak të asaj se çfarë ka ndodhur paraprakisht në internet apo në rrjetet sociale.

TABELA 1. NË ÇFARË FORME FËMIJËT KANË PËRJETUAR DIÇKA TË DËMSHME OSE TË PAKËNDSHME NË INTERNET

	Frekuenca	Nëpërqindje
Përmes rrjeteve sociale	118	53.2
Përmes mesazheve në internet	77	34.8
Çat – Mesenxher	59	26.7
Me email	35	15.8
Në webfaqe të lojërave	19	8.6
Përmes telefonit, me tekst apo video	20	9.1
Në ndonjë mënyrë tjetër	23	10.5
Nuk e di	32	14.5
	383	-

REKOMANDIMET

- Ndërgjegjësimi i prindërve lidhur me rrezikun dhe sigurinë e fëmijëve në internet duhet të rritet. Kjo mund të bëhet me rritjen e njohurive për llojet e rreziqeve që fëmijët e tyre mund të hasin gjatë qëndrimit online.
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i mësuesve në lidhje me sigurinë në internet që do të rezultonte në edukimin e fëmijëve për përdorim të sigurt të internetit nëpër shkollë.
- Politikë-bërësit duhet të sponsorojnë më shumë hulumtime rreth përdorimit të internetit, sigurisë online dhe rreziqeve që lidhen me përdorimin e internetit.
- Industria duhet të ofrojë më shumë mbështetje programeve dhe aktiviteteve për sigurinë në internet dhe për të mbrojtur fëmijët në internet, duke ofruar mundësi filtrimi, bllokimi, raportimi, përmes të ashtuquajturve 'Parental Control' dhe 'Technical tools'.
- Më shumë ndihmë duhet tu ofrohet fëmijëve dhe prindërve lidhur me njohuritë e duhura për të bërë bllokimin e përmbajtjeve të padëshiruara që shfaqen aksidentalisht, për shembull, fotografitë, filmat apo videot me përmbajtje të papërshtatshme për moshën e tyre.
- Duke e marrë parasysh përqindjen e lartë (58%) e takimit të fëmijëve me persona nga interneti, fëmijët duhet të informohen lidhur me rreziqet e mundshme nga takimet e tilla. Më shumë përgjegjësi në këtë aspekt duhet të marrin prindërit dhe mësuesit.

Qendra për studime të avancuara FIT

Adresa: Rruga Eqrem Qabej, nr 166,
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

E-mail: info@fit-ks.org
www.fit-ks.org
www.internetisigurte.org

Save the Children

Gazmend Zajmi nr.1, 10000 Prishtine Kosove
Phone: +381 (0) 38 55 26 91
Fax: +381 (0) 55 26 90
scik@savethechildren.org
www.savethechildren.net
www.kosovo.savethechildren.net
www.facebook.com/savethechildreninkosova



Vlerësimi i përdorimit të internetit, rreziku, dhe siguria në mesin e fëmijëve



OBJEKTIVAT

Kjo fletëpalosje paraqet gjetjet kryesore dhe rekomandimet e dalta nga hulumtimi "Vlerësimi i përdorimit të internetit, Rreziku dhe Siguria në mesin e fëmijëve nga moshën 9-16 në Kosovë/ Promovimi i mënyrave të sigurta të hulumtimit në internet nga ana e fëmijëve". Përmes këtij hulumtimi ne jemi munduar të mësojmë për përvojat e fëmijëve online në mënyrë që të informojmë opinionin e gjërë kosovare dhe politikë-bërësit me qëllim që ata të ndër marrin veprime të duhura për të mbrojtur fëmijët nga rreziqet në internet. Në pyetësor kanë marrë pjesë 1,150 fëmijë të moshave 9 deri 16 vjeç nga komuna e Prizrenit, Mitrovicës, Prishtinës, Pejës, Ferizajt, Gjilanit, dhe Gjakovës.

PËRDORIMI I INTERNETIT NGA FËMIJËT

Të dhënat e nxjerra nga hulumtimi tregojnë që fëmijët në Kosovë janë përdorues shumë aktiv të internetit.

- 93% e fëmijëve të anketuar kanë deklaruar që janë përdorues të internetit, ndërsa 63% e tyre e përdorin internetin çdo ditë ose gati çdo ditë.
- Tri pajisjet më kryesore që përdoren nga fëmijët për t'u kyqur në internet janë: kompjuterët personalë (PC-të) (70%), telefonat celularë (60%), dhe laptop-ët (50%).

FIGURA 1. SA SHPESH E PËRDORIN INTERNETIN FËMIJËT NË KOSOVË DHE EUROPE?





FIGURA 2. SA SHOKË PËRAFËRSISHT I KANË FËMIJËT NË FACEBOOK OSE TWITTER?



AKTIVITETET E FËMIJËVE NË INTERNET

Përmes pyetësorit tonë jemi përpjekur të kuptojmë se për çfarë e përdorin fëmijët internetin më shumë. Kjo për faktin se duke monitoruar atë se çfarë bëjnë fëmijët në internet, prindërit dhe politikë-bërësit mund të vlerësojnë shkallën e rrezikshmërisë nga të qenurit online.

- Sipas të anketuarëve, ndër aktivitetet më të pëlqyera në internet janë Facebook (74%), dëgjimi i muzikës (70%), YouTube (58%), lojërat online (46%), dhe Instagram (22%);
- 84% e fëmijëve kanë llogari të veten aktive në Facebook ose Twitter, prej të cilëve 32% kanë mbi 400 miq;
- 92% postojnë fotografi në profil, 67% postojnë emrin e shkollës, kurse 33% tregojnë e-mail adresën e tyre.

RREZIQET NË INTERNET

Ka shumë forma të rreziqeve potenciale që shfaqen nga përdorimi jo i sigurt dhe i tepruar i internetit. Rreziqet kryesore nga përdorimi jo i sigurt i internetit janë këto: sjambërdhuna, keqpërdorimi i të dhënave personale, kontakti me të panjohurit, përmbajtja joadekuata (psh. pornografia, dhuna, etj.), qëndrimi i gatë në internet dhe varësia nga interneti, virusët dhe spam-etj. Fëmijët kanë raportuar të dhëna shqetësuese në lidhje me aktivitetet e tyre online:

- 42% e fëmijëve kanë deklaruar që kanë parë përmbajtje pornografike në internet dhe janë shqetësuar nga ato pamje, ndërsa 61% kanë deklaruar që kanë parë foto ose video me përmbajtje luftarake dhe agresive;
- 58% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë kontaktuar përmes internetit me persona të panjohur, 69% e të cilëve janë takuar edhe personalisht me persona të panjohur;
- Fëmijët kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit kompjuteri ju është sulmuar nga ndonjë virus (55%), dikush ju ka keqpërdorur të dhënat personale (15%), ju është vjedhur e-maili (20%), janë ndier të rrezikuar apo të kërcënuar (12%);
- Gjithashtu 52% e fëmijëve kanë thënë që shpesh janë të mërzitur, trishtuar, ose të përlotur, ndërsa 40% kanë pohuar që kanë frikë nga gjëra të shumta dhe frikohen lehtë.

FIGURA 3. SA JANË TË SHQETËSUAR FËMIJËT NGA TAKIMET ME PERSONA TË PANJOHUR CILËT PËR HERË TË PARË I KANË NJOHUR PËRMES INTERNETIT.

